

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		23/06/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400/01-	23938	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Opština Drenas –Municipality of Drenas  
Zyra e Kryetarit



**Data/Date:** 22/06/2026

**Nga/Od/From:** Grupit Punues për Dëgjimet Buxhetore 2027-2029

**Për/Za/To:** Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit

**Tema/Subjekat/Subject:** Procesverbali nga procesi i dëgjimit të parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2027-2029

## P R O C E S V E R B A L

i dëgjimit të parë publik për:

### KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2027-2029

Pas themelimit të Grupit Punues për organizimin e hershëm buxhetor dhe planifikimin e dëgjimeve Buxhetore komunale për vitin 2027, sipas vendimit të kryetarit nr. 01-400/01-17089, i datës: 13/05/2026, dhe ftesës për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2027-2029, nr. 01-060/03-18092, i datës 20/05/2026, linqet në ueb-faqe të komunës: <https://gllogoc.rks-gov.net/neës/f-t-e-s-e-per-pjesemarrje-ne-takim-lidhur-me-degjimin-e-pare-publik-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/> ; si dhe linku në Facebook: [https://ëëë.facebook.com/komunadrenas?\\_cft\\_\[0\]=AZZILNgIIEv5rl7KxQbaLVQbYVeFGMHqëKDCd4Eof8x9mJPYop1nm00MigtHEiM0vËPkbBNknvyuisupg4s316NBaeyJ2kF9NPQËL957oTMX0JËsHBYHUXEVx6BrKI5suMKJËnLmRgNBhTOgDz7b9m5&\\_tn=-UC%2CP-R](https://ëëë.facebook.com/komunadrenas?_cft_[0]=AZZILNgIIEv5rl7KxQbaLVQbYVeFGMHqëKDCd4Eof8x9mJPYop1nm00MigtHEiM0vËPkbBNknvyuisupg4s316NBaeyJ2kF9NPQËL957oTMX0JËsHBYHUXEVx6BrKI5suMKJËnLmRgNBhTOgDz7b9m5&_tn=-UC%2CP-R) ; u mbajt takimi i parë publik.





REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	20/05/2026		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/03	18032	



Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit  
Drenas, më 20.05.2026

## F t e s ë

Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci së bashku me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve me publike me qytetarë për përgatitjen e KAB-it (Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029).

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, shoqata e grave, shoqëria civile, biznese të Komunës së Drenasit dhe gjithë të interesuarit, se më datën 29.05.2026, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të pranuar komentet, sugjerimet, propozimet dhe kërkesat hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft- Buxheti Komunal 2027-2029 janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoheni të drejtën tuaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni në përmirësimin e cilësisë së jetës suaj.

Komentet, kërkesat, propozimet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më 30.05.2026 në orën 16:00, në e-mail-at e zyrtarëve: [enver.m.hoxha@rks-gov.net](mailto:enver.m.hoxha@rks-gov.net) ; [bekim.dobra@rks-gov.net](mailto:bekim.dobra@rks-gov.net) dhe [komuna.drenas@rks-gov.net](mailto:komuna.drenas@rks-gov.net)

Për më shumë detaje, për organizimin e konsultimit publik për KAB-in, mund t'i referoheni qarkoreve në vegëzat:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:  
<https://glogoc.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/>

Platformën për Konsultime Publike:  
<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook: <https://www.facebook.com/komunadrenas/>



Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes së dëgjimeve:

Dëgjimet publike për KAB	Data e mbajtjes së dëgjimeve	Vendi	Ora
Dëgjimi i parë publik me grupe të nënperfaqësuar (administratorë të vendbanimeve, këshillat lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtor shëndetësor, Drejtor të shkollave, mësues, biznese, fermerë, OJQ-të, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj).	29.05.2026	Salla e Kuvendit	14:00

Ju mirëpresim!



**Bekim Dobra**

**Udhëheqës i Zyres për Komunikim me Publikun**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E DRENASIT



# FTESË PËR DËGJIM PUBLIK

PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2027-2029

Komuna e Drenasit **ju fton** të merrni pjesë në dëgjim publik për  
Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029.



DATA

29.05.2026



VENDI

SALLA E  
KUVENDIT



ORA

14:00

## CILAT GRUPE JANË TË FTUARA?



DËGJIMI I PARË PUBLIK  
ME GRUPE TË NËNPËRFAQËSUARA



ADMINISTRATORE  
TË VENDBANIMEVE



KËSHILLAT  
LOKALE



GRA



TË RINJ



STUDENTË



PENSIONISTËT



PERSONAT ME  
AFËTËSI TË KUFIZUARA



PUNËTORE  
SHËNDËTËSORE



DREJTORE TË  
SHKOLLAVE



MËSIMDHËNËS



BIZNESE



FERMERË



OJQ-të



SHOQËRI CIVILE



KLUBET  
SPORTIVE



KLUBET  
ARTISTIKE

ETJ.



## BËHU PJESË E VENDIM-MARRJES!

Kontributi juaj është i rëndësishëm për të ndërtuar një buxhet transparent,  
të drejtë dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës së Drenasit.



PLATFORMA PËR KONSULTIM  
PUBLIK PËR KAB:  
[https://glogoc.rks-gov.net/  
degjimet-buxhetore/](https://glogoc.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/)



KOMENTET, IDETË DHE  
SUGJERIMET PËR KAB:  
[enver.m.hoxha@rks-gov.net](mailto:enver.m.hoxha@rks-gov.net)  
[bekim.dobra@rks-gov.net](mailto:bekim.dobra@rks-gov.net)



FACEBOOK:  
[https://www.facebook.com/  
komunadrenas/](https://www.facebook.com/komunadrenas/)

Bashkë për një Komunë më të mirë dhe gjithëpërfshirëse!

P R O C E S V E R B A L



Vendi i takimit	Data	Ora
Salla e Kuvendit, Komuna e Drenasit	E premte, 29 Maj 2026	14:00

Në Sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit është mbajtur dëgjimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB 2027-2029.

Ky takim u udhëhoq nga nënkryetari i Komunës së Drenasit, Arben Shala, u mbajt më 29.05.2026, në orën 14:00. Në takim, përveç bartësve përgjegjës, në përbërje nga Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2027-2029 dhe bartësve mbështetës të dëgjimit, në përbërje nga Nënkyetari i Komunës, Zyra për Informim, Drejtor të Drejtorive dhe njësitet tjera të komunës ishin të pranishëm edhe përfaqësues të grupeve të ndryshme të komunitetit, përfshirë administrator të vendbanimeve, këshilla lokale, gra, të rinj, studentë, pensionistë, drejtorë të shkollave, mësimdhënës, biznese, fermerë etj.

Gjatë takimit, qytetarët patën mundësi të paraqesin kërkesat, ankesat, shqetësimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me nevojat e komunitetit dhe prioritetet që duhet të merren parasysh në planifikimin buxhetor për periudhën 2027–2029.

Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte përfshirja e qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm, duke u dhënë mundësi të kontribuojnë me propozime konkrete për prioritetet zhvillimore të Komunës së Drenasit.

Komuna e Drenasit ka theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, me synim ndërtimin e një buxheti më transparent, më gjithëpërfshirës dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve.

Nënkyetari i Komunës së Drenasit, **Arben Shala**, duke e hapur

takimin i përshëndeti pjesëmarrësit dhe ndër tjerash tha: të nderuar drejtorë të drejtorive komunale, anëtarë të Kuvendit të Komunës, administratorë të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, organizatave jo qeveritare, ju qytetarë. Jemi mbledhur sot në këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Ky dokument është përgatitur në bazë të Qarkores Buxhetore 2027/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, e cila paraqet përmbledhjen e kërkesave fillestare të planifikimit e parashikimit për vitin 2027 dhe projeksionit të buxhetit për vitet 2028-2029. Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën. Që nga muaji maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar

Qarkoren Buxhetore. Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029 dhe draft-Listën e Investimeve Kapitale, do ti bëjë publike dhe ju qytetarë, mund të shihni e të jepni propozime në dëgjimet tjera që do të mbahen gjatë muajit Gusht dhe Shtator. Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të bëhet një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Sot në këtë takim do të keni mundësi të prezantoni projektet tuaja që janë në prioritet. Takime të tilla na ndihmojnë të përcaktojmë projektet më jetike për ju, që të i realizojmë në vitet e ardhshme.



**Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht lus që kur ta merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit të takimit.**

Fjalën e mori **Semedin Kiqina**, përfaqësues nga fshati Baicë: - Rruga Mulliri i Vjetër është e pakalueshme. Po ashtu, nevojitet rregullimi i rrugës Halil Xhylani, rrugës që të çon te shkolla (rreth 300 m), ujësjellësit të fshatit, fushës sportive, si dhe rrugëve Milazim Kiqina, Vllaznit Elshani dhe Petrit Kiqina.

**Murat Elshani**, administratori i fshatit Gllobar: - Kam tri pyetje për drejtorinë përkatëse:

1. Infrastruktura – Kur do të përfundojë kanalizimi për tri shtëpitë në lagjen Elshani dhe në lagjen Krasniq? Gjithashtu, trotuari në rrugën “Sylejman Elshani” ka mbetur përgjysmë i përfunduar, ndërsa rruga në lagjen Tahir Krasniqi, e cila lidhet me rrugën “Sylejman Elshani”, ka nevojë për investime. Kërkojmë edhe instalimin e ndriçimit publik në Gllobar.
2. Shërbimet Publike – Mirëmbajtja e varrezave dhe përkrahja e iniciativave të qytetarëve për mirëmbajtjen e fshatit me pajisjet e nevojshme.
3. Planifikimi Hapësinor dhe Mbrojtja e Mjedisit – Fidanët e mbjellë nga komuna të mirëmbahen nga kompania që ka kryer punimet deri në përfundimin e plotë të projektit.

**Hafiz Muja**, administratori i fshatrave Gradicë dhe Likoshan: -Kërkojmë rregullimin e rrugës që lidh lagjen Fazliu me lagjet Selmani, Dervishi dhe Uka, si dhe të rrugicave në lagjet Uka, Bardhi dhe Muja si dhe në Likoshan, në tri ose katër lagje, në Gradicë nevojitet shtrirja e rrjetit të ujësjellësit të përfshihet lagjia Fazliu, Uka dhe Dervisholli. Gjithashtu, në rrugën “28 Shkurti”, duhet të rregullohen gypat dhe të hapen kanalet kulluese, pasi po dëmtohet edhe rruga.

**Zekë Kluna**, administratori i fshatit Vasilevë: -Kërkojmë zhblokimi i gropës septike, rregullimi i rrethojave pranë shkollës dhe ambulancës, përmirësimi i ndriçimit publik, ujësjellësit, rrugicave dhe rrugës “Martirët Muqolli”.

**Kadri Ajazi**, administratori i fshatrave Sankoc, Fushicë e Epërme dhe Fushicë e Poshtme: -Si prioritet kemi trotuarin, shtrimin e rrugicave në fshatrat në fjalë, ndriçimin publik dhe rregullimin e fushës sportive në Fushicë të Epërme. Një problem tjetër që kemi është edhe ujësjellësi, i cili nuk i plotëson nevojat e fshatit.

**Xhafer Dobërdolani**, administratori i fshatit Korroticë e Epërme: -Tri lagje ende nuk kanë kanalizim dhe furnizim të rregullt me ujë. Gjithashtu, ka rrugë që nuk janë përfunduar dhe trotuare që janë shumë të nevojshme për banorët.

**Gentrit Mulaku**, nga Ansambli “Shqipet e Drenicës”: -Komuna e Drenasit ka qenë gjithmonë përkrahëse e kulturës. Kemi pasur një kërkesë për transport, e cila është realizuar nga Drejtoria e Kulturës. Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe mbështetjen.

**Avni Xhemajli**: -Kam tri çështje për diskutim. Së pari, a do të vazhdojnë punimet për rregullimin e shtratit të lumit Drenica, Së dyti, si organizatë joqeveritare kemi mundësi të tërheqim fonde nga Bashkimi Evropian, por një nga kushtet është që mjetet të kalojnë në llogarin e komunës së Drenasit dhe si mund të na siguroni që këto mjete të shfrytëzoheshin në interes të nxënësve dhe komunitetit.

Së treti, nxënësit e Drenasit po arrijnë suksese në gara brenda dhe jashtë Kosovës, prandaj propozoj krijimin e një fondi të veçantë për përfaqësimin ndërkombëtar të nxënësve nga komuna jonë.

**Arbnor Istogu, administrator I fshatit Polluzh:** - ju lutem të I mbaroni kërkesat e vitëve të më hershme që janë asfaltim në lagjen Kastrati, Veliqi dhe lagjen Istogu, kërkesa të reja janë: problemi me kanalizim dhe zgjerim të reka, ndriqimi ka nevoj të rregullohet, renovimi I fushës sportive dhe rrethojave, mbulimi I disa pusetave të kanalizimeve në lagjen Kastrati dhe Veliqi.

Gjatë procesit të konsultimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029, në shqyrtim publik ju është dhënë mundësia që edhe përmes formës elektronike të paraqesin kërkesat. Në emailat që janë dhënë ne njoftimin publik, kemi pranuar dhjetëra kërkesa dhe ato do të përmendim secilën ne këtë procesverbal si me poshtë;

**Shkurta Dvorani, Drejtorja e SHFMU “ Naim Frashëri “ në Gllobar,** ju njofton lidhur me nevojat për investimet kapitale në institucionin tone dhe njekohësisht paraqet kërkesën për përfshirjen e tyre në planifikimet buxhetore për vitet në vijim. Duke u bazuar në gjendjen aktuale të infrastrukturës shkollore dhe nevojën për përmiresimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor, projektet prioritare paraqiten si më poshtë:

1. Kompletimi i 4 klasave në aneksin e ri të shkollës me 50 banka dhe 100 karrige, me qëllim fillimin e mësimin në një ndërrim. (Sasia: 150, Viti: 2026)
2. Ndërtimi i një depoje për deponimin e druve të zjarrit. (Viti: 2026)
3. Ndërrimi i dritareve dhe dyerve në pjesën e mbetur të objektit të shkollës – vazhdim i projektit. (Sasia: 7, Viti: 2026)
4. Rinovimi i banjove në objektin e shkollës. (Sasia: 3, Viti: 2026)
5. Pajisja me kamera të sigurisë për aneksin e ri të shkollës, me qëllim fillimin e mësimin në një ndërrim – vazhdim i projektit. (Sasia: 10, Viti: 2026–2027)
6. Ndërtimi i një klase verore në oborrin e shkollës. (Sasia: 1, Viti: 2026–2027)
7. Krijimi i këndit të lodrave (oborr-kopsht) për fëmijët e shkollës, me lodra të ndryshme. (Sasia: 10, Viti: 2026–2028)
8. Shtrimi i fushave sportive me tepison adekuat. (Sasia: 2, Viti: 2026–2029).

**Koment: Luljeta Nebihu, anëtare e grupit punuës.** Pas pranimit të kërkesës dhe shqyrtimit të të gjitha pikave të paraqitura në kërkesë shumica janë të realizuara përveq pikës:

2. Depo per depozitimin e druve te zjarrit
7. Këndin e lodrave (oborr-kopsht) për fëmijet e shkollës, lodra të ndryshme
8. Shtrimi i fushave të sportit me tepison adekuat

Këto kërkesa sipas këtyre pikave do të shqyrtohen në kuadër të planifikimit buxhetor për vitet në vijim për mundësinë e realizimit të tyre.

**Edon Nishori, asambleist.** 1. Një fushë sportive për banorët e Komoran 3 të cilen mund ta shfrytezojn edhe banoret e Kishnarekës.

2. Një fushë sportive në Komoran 2 tek lagjia Nishori, Bashot, Zogaj, Grudoj dhe Ibriqi të cilët bashkarisht mund ta shfrytëzojn këtë fushë sportive. Sygjerohet të ndërtohet tek lagjia Nishort e



nalt sepse ka hapsirë dhe ne të ardhmen është afer edhe parkut atraktiv pushimor të pishave në komoran të cilën do ta bënte edhe me të frekuentueshme dhe turistike.

3. Të hapet një rrugë afër stacionit të policies te cilave do te ju mundesoj qasje direkte në brendësi të komoranit, pa pasur nevojë ti bien rrotull autostradës për kyqje në Komoran. Si rezltat I kësaj rruge të shkurtër jo me e madhe se 300 m atëherë do mundesonte përgjysmimin e kohës së reagimit të policisë në raste të nddryshme që prekin komunitetin tonë. Janë disa rrugë tek lagjia e re në Komoran që mund të krijohet qasje në levizje dhe reagim më të shpejt nga policia.

4. Kërkoj në emër të Komoranit të filloj vendosja e kamerave ne katër Komoranat në menyre që siguria e banoreve dhe pasuria e tyre të jetë e sigurt dhe nën vëzhgimin e kamerave nga policia. Sidomos tani që janë vendosur me nënstacion policor në Komoran.

5. Në emer të banorëve të Komoranit 3 dhe 4 kërkoj që qasja në ujësjellës të ju mundësohet. Në Komoran 4 ka mbetur vendosja e orëve dhe lidhja e banorëve ku kërkoj mbeshtetje nga komuna në mënyr që të ushtroj presion tek Ujësjellesi regjional. Ndërsa në Komoran 3 janë të demtuar gypat tersisht gjatë punimeve në rrugë dhe si rezultat duhet te largohen gjithë gypat e demtuar dhe te vendosen te rinjet ne menyre që të mundesohet qasja e banorëve të Komoranit 3 në ujësjellës.

6. Mbushja me zhavor apo ne te ardhmen edhe asfaltimi I nje rruge vitale e cila përfundimisht lidhë Komoranin 1 dhe Komoranin 2 duke shkarkuar ter komunikacionin I cili bëhet tek kryqi ambullantës së Komoranit.

Rruga është pa emër por figuron si pronë jo private ( në fund të rrugës Ali Lladrovci) dhe kapet me rrugën Avdullah Cakaj, apo si njihët më gjuhë të popullit nga shtëpia e Ejup Thaqit deri te dalja e shtëpive të haxhiavitve.

7. Vendosjen e kamerave monitoruese ne lokacionin tek pishat ne Komoran e cila përkon edhe me zonën e Fushticës dhe Sankocit.

Nga mos monitorimi dhe nga njerëz te pandergjegjshëm po hidhet bërllogu duke e kthyer atë vend atraktiv në një vend të padëshirushëm andaj vendosja e kamerave dhe ndeshkimi I atyre që ndotin natyrën do të ishte hapi vendimtar për të parandaluar këtë dukuri negative.

8. Si banor dhe përfaqesuës I Komoranit kërkoj që në buxhetin afatmesëm 2027-2029 të rinovohet tërësisht rruga Skender Mulaku e cila lidh Komoranin 1, Komoranin 3 deri të Kizhnareka. Është rrugë vitale e cila duhet rregulluar teresishtë por ne disa pjesë është aq e demtuar sa që duhet rregulluar edhe sbtrari I tokës me një bazament të fortë dhe pastaj të shtrohet asfalti I ri.

9. Në vijim ju paraqes një kërkesë thelbesore apo elementare që rruga Agron Krasniqi në Komoran 4 ( ngjitur me Jora Center) të rinovohet duke u shtruar asfalti I rip or fillimisht të rregullohet shtresa e tokës sepse nga x ndërhyrjet gjatë viteve që kane kaluar tashme ajo rrugë është bërë shumë e veshirë për banoret e Komoranit 4 të cilet shpeshherë I demtojn veturat në atë rrugë e cila është kryesore për qasjen në shtëpit e tyre.

**Koment: Bislime Dvorani, anëtare e grupit punuës.** Lidhur me kërkesën tuaj të paraqitur përmes email më datë 25.05.2026, për vendosjen e kamerave në Komoran, vendosjen e kamerave monitoruese në lokacionin te pishat në Gllobar, rinovimin e rrugës në Komoran III, rr.Skender Mulaku, pastrimin dhe mirëmbajtjen e trotuarit në rrugën Drenas–Komoran, si dhe rregullimin dhe menaxhimin e parkingjeve për banorët e banesave kolektive dhe vendosjen e rampave në dy parkingjet përkatëse, ju njoftojmë si vijon:

- Në planifikimin buxhetor për vitin e ardhshëm janë paraparë mjete financiare për vendosjen e kamerave të sigurisë në Komoran.



- Sa i përket vendosjes së kamerave mobile në lokacionin te pishat në Gllobar, ju njoftojmë se pajisjet janë në dispozicion dhe mund të bëhet vendosja e tyre.
- Gjatë këtij viti, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë është duke realizuar projektin “Rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara në Komunën e Drenasit”. Në kuadër të këtij projekti do të bëhet sanimi i gropave dhe dëmtimeve në këtë rrugë. Megjithatë, rehabilitimi i plotë i saj nuk është në kompetencë të kësaj drejtorie, por i Drejtorisë së Infrastrukturës.
- Lidhur me pastrimin dhe mirëmbajtjen e trotuarit në rrugën Drenas–Komoran, ju njoftojmë se kjo rrugë është nën kompetencën e Ministrisë së Infrastrukturës.
- Sa i përket rregullimit dhe menaxhimit të parkingjeve për banorët e banesave kolektive, si dhe vendosjes së rampave në dy parkingjet përkatëse, ju njoftojmë se vendimmarrja për këto çështje është në kompetencë të menaxhmentit me të lartë komunal, duke u bazuar në kërkesat e banoreve.

Ju sigurojmë se mbetemi të përkushtuar në adresimin e nevojave të qytetarëve dhe do t’ju informojmë për çdo zhvillim të mëtejshëm lidhur me këto çështje.

**Koment: Vlora Gjinovci, anëtare e grupit punuës. Pyetja 6.** Drejtoria e Infrastrukturës Lokale kërkon bashkëpunimin e qytetarëve për kthimin e pronave private në pronë publike, në mënyrë që të krijohen mundësi për realizimin e investimeve infrastrukturore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Pyetja 8.** Brenda mundësive buxhetore, do të shqyrtohet renovimi i rrugës “Skënder Mulaku”, e cila lidh Komoranin 1 dhe Komoranin 3 me Kizhnarekën. Duke marrë parasysh numrin e madh të kërkesave për këtë zonë, investimet do të realizohen sipas prioriteteve të përcaktuara.

**Pyetja 9.** Drejtoria e Infrastrukturës Lokale planifikon që gjatë periudhës 2027–2029 të përfundojë rregullimin e këtij segmenti rrugor, i cili paraqet një unazë të rëndësishme lidhëse.

**Burim Istogu, drejtor në Shkollën Filllore “Shaban Polluzha” Polluzhë.** Duke ju falënderuar për investimet e deritanishme në shkollën tonë, në kuadër të planifikimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029, paraqes këto kërkesa:

1. Shtrimin e fushës sportive me gomë ose bari sintetik;
2. Pajisjen e shkollës me 3 tabela Smart;
3. Rinovimin e hapësirave të brendshme të shkollës.

Si kërkesë shtesë, do të ishte shumë e mirëseardhur ndërtimi i një salle sportive në SHFMU-në “Zenel Hajdini” në Tërstenik I. Kjo sallë do t’u shërbente pesë shkollave të kësaj pjese, duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe edukative.

Duke shpresuar në mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj, ju falënderoj paraprakisht për shqyrtimin e këtyre kërkesave.



**Koment: Luljeta Nebihu, anëtare e grupit punues.** Duke u bazuar në kërkesën e parashtruar nga Drejtori Burim Istogu SHFMU"SHABAN POLLUZHA"-Polluzhë  
Sa i përket pikes 2.Pajisjen e shkollës me 3 tabela Smart dhe pikes 3.Rinovimin e hapësirave të brendshme të shkollës,  
ju njoftojmë se këto kërkesa do të realizohen në kuadër të planifikimeve dhe mundësive buxhetore. Ndërsa pikat e tjera nuk mund të realizohen në afat të shkurtër, por do të shqyrtohen në planifikimet e ardhshme investive.

**Shpend Shala,** Duke qenë banor i përhershëm i Komunës së Drenasit dhe duke marrë parasysh faktin që edhe qytetarët kanë të drejtë të japin ide dhe sugjerime për zhvillimin e komunës sonë, dëshiroj të paraqes disa propozime konkrete që besoj se do të ndikonin drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të infrastrukturës publike.

1. Rregullimi i pjesës së jashtme të ndërtesave kolektive në Drenas (5 blloqe). Kërkoj që të bëhet renovimi dhe izolimi i jashtëm i ndërtesave kolektive në Drenas, pasi gjendja aktuale është shumë e rënduar dhe shumica e banesave kanë problem serioz me lagështinë dhe mykun. Po ashtu, është e nevojshme:

- Rregullimi i hyrjeve të banesave;
- Përmirësimi i kushteve të përbashkëta të banorëve;
- Vendosja e ashensorëve, ashtu siç është realizuar në Komunën e Podujevës dhe në Komunën e Skenderajt, ku janë ndërmarrë projekte të ngjashme për banesat kolektive.

2. Rregullimi i shtegut të biçikletave sipas standardeve modern. Shtegu aktual i biçikletave nuk ofron siguri të mjaftueshme për qytetarët. Në shumicën e vendeve moderne, korsitë e biçikletave ndahen fizikisht nga rruga e automjeteve, qoftë me ngritje në nivel më të lartë apo me mbrojtëse anësore. Një model i tillë është aplikuar edhe në Tiranë. Propozoj që edhe në Drenas të bëhet:

- Ndarja fizike e shtegut të biçikletave nga rruga;
- Ngritja e standardit të sigurisë për çiklistët;
- Krijimi i një infrastrukture moderne dhe funksionale për lëvizje alternative.

3. Rregullimi i oborrit të Shkollës Filllore "Rasim Kiçina". Gjendja e oborrit të kësaj shkolle është shumë e dobët dhe nuk përfaqëson standardin që duhet ta ketë një institucion arsimor.

Propozoj:

- Rregullimin e oborrit (hapësira e gjelbërt shkelet nga secili nxënës ose edhe nga prindërit);
- Krijimin e hapësirave rekreative për nxënësit (të vendoset bari artificial në fushën e futbollit; sugjerim – merrni statistikën në QMF dhe shikoni sa nxënës lëndohen në fushën me beton);
- Gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e ambientit shkollor, në mënyrë që kjo shkollë të jetë shembull për zonën.



4. Pastrimi dhe mirëmbajtja e trotuarit në rrugën Drenas–Komoran. Trotuari në këtë segment rrugor është në gjendje të rënduar, i mbuluar nga bari dhe mbeturinat, duke vështirësuar lëvizjen e këmbësorëve.

Kërkoj:

- Pastrimin urgjent të trotuarit (pavarësisht se rruga është kompetencë e nivelit qendror);
- Mirëmbajtje të rregullt nga shërbimet komunale;
- Rritjen e sigurisë dhe higjienës publike në këtë zonë.

5. Rritja e kapacitetit të furnizimit me ujë. Problemet me furnizimin me ujë janë shqetësim i vazhdueshëm për banorët.

Propozoj:

- Bashkëpunim më të madh ndërmjet Komunës së Drenasit dhe KRU “Prishtina”;
- Rritjen e kapaciteteve të furnizimit me ujë në Bivolak;
- Vendosjen e pompave me sistem rezervë (redundancë), për të shmangur ndërprerjet;
- Shqyrtimin e mundësisë për mbështetje të banorëve në vendosjen e rezervuarëve të ujit mbi ndërtesat e banimit.

6. Rregullimi dhe menaxhimi i parkingjeve për banorët e banesave kolektive. Mungesa e organizimit të parkingjeve është problem i vazhdueshëm për banorët.

Propozoj:

- Rregullimin dhe asfaltimin e parkingjeve ekzistuese;
- Vendosjen e rampave (“laurave”) në dy parkingjet e banesave kolektive;
- Funkcionalizimin e parkingjeve me pagesë simbolike, në mënyrë që të sigurohet mirëmbajtja dhe menaxhimi më i mirë i tyre.

Këto projekte janë të realizueshme dhe do të ndikonin drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Shpresoj që këto propozime të merren në konsideratë gjatë hartimit të buxhetit për vitet 2027–2029.

**Koment: Vlora Gjinovci, anëtare e grupit punuës.** 2. Rregullimi i shtegut të biçikletave sipas standardeve moderne.

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale është duke investuar në zgjerimin e rrugëve brenda qytetit. Pas përfundimit të këtij cikli investimesh, do të realizohet ridizajnimi i hyrje-daljeve të qytetit dhe do të trajtohet edhe rregullimi i shtegut të biçikletave sipas standardeve bashkëkohore.

5. Rritja e kapacitetit të ujit

Komuna ka investuar në rregullimin dhe riparimin e rrjetit të ujës-jellës brenda dhe jashtë qytetit. Sa i përket rritjes së kapacitetit të furnizimit me ujë, kjo çështje është në kompetencë të KRU Prishtina, e cila menaxhon sistemin e furnizimit me ujë.



**Koment: Petrit Gashi, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit,**  
1. Sa i përket Propozimeve për Buxhetin 2027–2029 dhe përmirësimin e infrastrukturës në Komunën e Drenasit, konkretisht Rregullimi i pjesës së jashtme të ndërtesave kolektive në Drenas (5 blloqet), ku kërkohet të bëhet renovimi dhe izolimi i jashtëm i ndërtesave kolektive në Drenas, rregullimi i hyrjeve të banesave dhe përmirësimi i kushteve të përbashkëta të banorëve së bashku me vendosjen e ashensorëve, Komuna e Drenasit, konkretisht Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit në bazë të mundësive buxhetore do ta shqyrtoj një gjë të tillë pasi ka qënë dhe mbetet një prej projekteve të përhershme në të cilet mendojme të investojmë. Duke pasur parasysh që DUMM për këtë vit për shkak të kontratës kolektive dhe përmbaruesve nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të vazhduar këto projekte, mbetet që në vitet në vijim të planifikohet një buxhet për rregullimin e këtyre ndërtesave, rregullimin e hyrjeve, korridoreve, pullazave, liftave dhe pjesëve të tjera.

**Koment: Nexhmedin Gruda, Drejtor i Drejtorisë për Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.**  
5. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina”, takime të rregullta, me email, telefon.

Për të sqaruar përgjegjësitë institucionale lidhur me furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm, është me rëndësi të theksohet se legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës e përcakton qartë se ofrimi i shërbimeve të ujësjellësit është përgjegjësi e operatorëve të licencuar të ujësjellësit, përkatësisht Kompanive Rajonale të Ujësjellësit.

Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit përcakton se marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit, si dhe operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit dhe objekteve të ujësjellësit, janë përgjegjësi të ofruesit të licencuar të shërbimeve. Po ky ligj obligon operatorët që të sigurojnë standardet e furnizimit, cilësinë e ujit, vazhdimësinë e shërbimit dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

Ndërkohë, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale u jep komunave kompetenca në planifikimin lokal, zhvillimin e infrastrukturës publike dhe realizimin e investimeve kapitale, por nuk i përcakton komunat si operatorë të furnizimit me ujë.

Po ashtu, Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit janë ndërmarrje publike qendrore, aksionari i të cilave është Qeveria e Republikës së Kosovës. Për këtë arsye, komunat nuk e menaxhojnë drejtpërdrejt sistemin e furnizimit me ujë, edhe pse mund të kontribuojnë në investime infrastrukturore.

Edhe vetë Statuti i KRU “Prishtina” përcakton se veprimtaria e saj kryesore është furnizimi me ujë të pijshëm, mirëmbajtja e sistemeve të ujësjellësit dhe sigurimi i sasive të nevojshme të ujit për konsumatorët.

Prandaj, bazuar në kornizën ligjore në fuqi, përgjegjësia për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm, menaxhimin e rrjetit, mirëmbajtjen e sistemit dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit i takon Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit, ndërsa roli i komunës mbetet në planifikim, koordinim dhe mbështetje përmes investimeve në infrastrukturë.

6. Komuna e Drenasit deri me tani ka asfaltuar pesmbdhjete (15) parkingje me rrethe 1584 vendparkime, ndërsa për asfaltimin e parkingut të Banës Kolektive do të shohim mundësitë buxhetore për asfaltim.

Te gjitha vendparkimet janë të lira dhe pa pagesë për të gjithë qytetarët deri në një vendim të ardhshëm nga Komuna e Drenasit.



**Koment: Luljeta Nebihu, anëtare e grupit punues.** Lidhur me kërkesat e parashtruara të pikes 3. Rregullimi i oborrit të shkollës është në procedurë dhe realizohet në kuadër të projektit për rregullimin e sheshit i cili përfshin edhe sistemimin e hapësirave të gjelbra. Sa i përket hapësirave rekreative për nxënësit, ato kanë ekzistuar më herët, mirëpo si pasojë e punimeve që janë duke u zhvilluar në shesh një pjesë e tyre është dëmtuar. Pas përfundimit të punimeve, hapësirat rekreative do të rivendosen dhe funksionalizohen përsëri duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe rekreative.

Gjithashtu për fushen sportive me sipërfaqe betoni është paraparë që ajo të pajiset me tepih sportiv (bar artificial) për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

**Jetlir Berisha, Vasilev.** Kërkoj asfaltimin në rrugën Bejt Berisha në fshatin Vasilev.

**Koment: Vlora Gjinovci, anëtare e grupit punues.** Drejtoria e Infrastrukturës Lokale planifikon të investojë në asfaltimin e rrugës “Bejt Berisha” gjatë periudhës 2026–2027.







**Nenkryetari Arben Shala:** Ju rikujtoj se kërkesat tuaja për projeksione të ndryshme, mund ti adresoni edhe me shkrim deri me datë 29/05/2026.

Nëse dikush tjetër nuk ka për të shtuar diçka, apo ndonjë kërkesë, duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, ky takim përfundoni tani.

Me kaq takimimi mori fund në orën 15:30

Dokumentet e bashkëngjitura:

Ftesa për pjesëmarrje;

Lista e pjesëmarrësve.

Procesmbajtësi

**Fluida Nika**

**Zyrtare e Lartë për Financa**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Drenasit



Lista e pjesemarrjes ne degjimet buxhetore  
Qarkorja buxhetore 2027-01

Dt.  
29.05.2026

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi	Vendi	Gjinia F/ M
1	KLORE HIGZI	<i>[Signature]</i>	TERRAJ	
2	GAN C. TOGAT	<i>[Signature]</i>		
3	MUKAT ELIHANI	<i>[Signature]</i>	CILORAR	M
4	Gazmat Mulaku	<i>[Signature]</i>	KOMORAN	M
5	XHEVDET KRASNIQI	<i>[Signature]</i>	DEGROC VUGAR	M
6	HASIB TAHIRAJ	<i>[Signature]</i>	DRENAS I	M
7	FAYZ MIZI	<i>[Signature]</i>	KOMORAN	M
8	Edmond Kaxhari	<i>[Signature]</i>	POLLUZHE	M
9	BIGRAT MASIRATI	<i>[Signature]</i>	POLLUZHE	M
10	Veton Kastrati	<i>[Signature]</i>	POLLUZHE	M
11	Manigona Gilaneva	<i>[Signature]</i>	Verboce	F
12	Ashenije Bakiq	<i>[Signature]</i>	Drenas	F
13	FATOS PROKSHI	<i>[Signature]</i>	DRENAS II	M
14	HAZMI HOXHA	<i>[Signature]</i>	KRAJKONC	
15	ZENE KLINDA	<i>[Signature]</i>	Dokleto	M
16	ARBANOR ISTOGBU	<i>[Signature]</i>	POLLUZHE	M
17	HAFIE HUDA	<i>[Signature]</i>	GRANICE LIKESHAN	
18	Driton Bitalli	<i>[Signature]</i>	Drenas	M
19	Arni Xhemaghi	<i>[Signature]</i>	Drenas	M
20	Sadete Zariqi	<i>[Signature]</i>	Drenas	F
21	Herolinda Krasniqi	<i>[Signature]</i>	Komoran	F
22	Kiridonu Fejza-Ajezi	<i>[Signature]</i>	Komoran	F
23	Dielza Bojnabkani	<i>[Signature]</i>	Kishnareke	F
24	KAJTAR KASTRATI	<i>[Signature]</i>	GIRATORO E RE	M
25	Asim Bajupi	<i>[Signature]</i>	Arllut	M
26	Arani Audyl	<i>[Signature]</i>	Darsolltes	
27	Bekim Morina	<i>[Signature]</i>	Glllobova	M
28	Alpin Glllobova	<i>[Signature]</i>	DRENAS	M
29	BURIM ISTOGBU	<i>[Signature]</i>	POLLUZHE	M



30	Daut Viskari	Ormi	Komoran	M
31	ARON HISHORI	Butfun	KOMORAN	M
32	Fazil Hoxha	Butun	Imvaret	M
33	Iliridon Bevisler	Bois	Drenas	M
34	Kimele Qorri	Rilind	Drenas	F
35	KUSHTON DABRAETARI	Qorri	DRENAS	M
36	Enver Hoxha	Qorri (H)	Drenas	M
37	ADHUR BATA	Boj	KORÇE DRENAS	M
38	Hexumedin Gorda	Hesul	DSHPE-Drenas	M
39	Katrina Pedkingj	KQer	DSHMS-Drenas	F
40	LAVETA THAQI	Ilirija	DAP	F
41	EMIRIT GLARSHI	Ilirija	DIL	M
42	ARAIT ELSHANI	Qorri	DRENAS	M
43	ARSEN SHALL	Ilirija	Z. KEJETAPIT	M
44	ARON HASANI	Ilirija	ZI	M
45	Ekrem Franca	Ilirija	OKRS	M
46	Bekim Dobro	Boj	Z. Kejetunib	M





REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Drenasit



Lista e grupit punues per organizimin e hershem buxhetor dhe  
planifikimin e degjimeve buxhetore komunale per vitin 2027

Dt.  
09.06.2026

Shqyrtimi i kerkesave fillestare  
Qarkorja buxhetore 2027-01

Nr.	Emri dhe Mbledhja	Nenshkrimi	Vendi	Gjinia F/ M
1	Liridona Fejze-Ajazi	<i>[Signature]</i>	Drenas-Z.K	F
2	Manigona Gllaneva	<i>[Signature]</i>	DZHE	F
3	Arbenije Gllanens	<i>[Signature]</i>	DBZHE	F
4	Niellza Bajraktari	<i>[Signature]</i>	DIZ	F
5	Lumburje Xhijun	<i>[Signature]</i>	DSHPS	F
6	KASTAZ KASTRAFI	<i>[Signature]</i>	DKRS	M
7	Bekim Dobro	<i>[Signature]</i>	Zyra e Informimit	M
8	Enver Hoxha	<i>[Signature]</i>	D. Buxheti chrorje	M
9	Ximete Gorr.	<i>[Signature]</i>	DBF	F
10	Artur Haxhi	<i>[Signature]</i>	ZI	M
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				

